Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksper. shqyrtues dhe nënshkrimi:	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës:*
Ermal Shala:	06.05.2022	16.05.2022	*131-22*

1. BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 06.05.2022, **OE "FATI NET" SH.P.K. – Komoran, Drenas**, ka parashtruar ankesë me nr: 131-22, kundër vendimi për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "RED by Besa Security" LLC & K.S. Besa Security SH.P.K. - Prishtinë, dhe refuzim të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së, për aktivitetin e prokurimit numër **"33600-22-1745-1-2-1"**, me titull **"Furnizimi dhe instalimi i kamerave vrojtuese në Qendrën e Paraburgimit Pejë dhe Qendrën Korrektuese për femra në Lipjan** iniciuar nga **AK – Shërbimi Korrektues i Kosovës.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, vlerë e mesme, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **45,000.00€.**

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim:
Data e përgatitjes së njoftimit për kontratë: 10.03.2022
Afati i fundit për dorëzim të ofertave: 31.03.2022
Vendimi i AK-së dhe letrat standarde: 22.04.2022
Kërkesa për rishqyrtim pran AK: 25.04.2022
Vendimi i AK-së në kërkesën për rishqyrtim: 26.04.2022
Ankesa në OSHP: 06.05.2022

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092 të LPP-së, Ekspertet Shqyrtues ka shqyrtuar pretendimet ankimore.

2. DISPOZITAT E SHKELURA NGA AK DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

OE "FATI NET" SH.P.K. – Komoran, Drenas, pretendon se gjatë kësaj procedure të prokurimit, nga ana e AK-së janë shkelur këto dispozita të Ligjit 04/L-042; 04/L-237; 05/L-068; dhe ligjit 05/L-092.

- Neni 1 i LPP-së
- Neni 6 i LPP-së
- Neni 7 i LPP-së
- Neni 56.3 i LPP-së
- Neni 59 i LPP-së
- Neni 60 i LPP-së
- Neni 69 i LPP-së
- Neni 41 i RROUP

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET ANKIMORE

Të nderuar ne me dt. 22.04.2022 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është rekomanduar për kontratë grupi I**OE "RED by Besa Security L.L.C.& K.S. Besa Security SH.P.K.** , ndërsa neve jemi shpallur si tenderues të eliminuar me arsyetimin se:

[Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye : Ne katallogun e ofruar, ofertën teknike keni ofruar paisje te prodhimit te shtetit Kinez , sipas vendimit te Qeverise se Republikes se Kosoves dhe informimit nga Agjensioni i Shoqërisë së Informacionit (ASHI) paisjet e ofruara nga ana e juaj jane te ndaluara për shfrytëzim në rrjetin qeveritar në Republiken e Kosovës .

Fillimisht ju sqarojmë se në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, ne kemi ofertuar me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit në krahasim me OE e rekomanduar për kontratë dhe OE tjerë pjesëmarrës, duke plotësuar përveç tjerash edhe kriterin kryesor për dhënie të kontratës.

Ndërsa sa i përket arsyes së eliminimit ju sqarojmë se arsyeja e lartcekure AK-së për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit, nuk përkon me gjendjen reale dhe për më tepër është vetëm një tendencë për të na eliminuar neve edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret e kërkuara në FDT dhe tek njoftimi për kontratë.

Sa për rikujtim, ju sqarojmë se nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë shumë e qartë si në vijim:
"Operatori Ekonomik duhet te ofroj katalog apo ofertë teknike duke pershkruar te gjitha specifikacionet teknike te cilat i ofron specifikacionet duhet te jene te kjarta dhe të detajuara", ndërsa dëshmia e kërkuar dokumentare si në vijim: ***"Katallog apo oferte teknik me përshkrim te specifikacioneve teknike."***.

Kur analizohet kërkesa dhe dëshmia e kërkuar dokumentare atëherë kuptohet qartë që ne jemi eliminuar për një kërkesë e cila nuk ka qenë e përcaktuar në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë, prandaj autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së, ku përcaktohet s në vijim ***"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".***

Ne kemi ofruar katalogun ashtu siç ka qenë e përcaktuar në dosje të tenderit, andaj edhe arsyeja e AK-së për eliminimin tonë se kinse ekziston një vendim që e ndalon ofertimin me produktet që kemi ofertuar është i pa bazuar dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 56.3 LPP-së, pasi që një gjë e tillëështë dashur të përcaktohet në dosje të tenderit, mirëpo jo tani pasi qëështë bërë hapja dhe për më tepër vendimi që AK-ja e ka cekur është nxjerr pas hapjes së ofertave.
Pra ne po eliminohemi për një vendim i cili nuk ka ekzistuar para hapjes së ofertave dhe për një kërkesë e cila nuk ka qenë fare e përcaktuar as në dosje të tenderit dhe as tek njoftimi për kontratë, andaj edhe arsyeja e AK-së për eliminimin tonëështë e pa bazuar.

Ne me dt.26.04.2022 kemi pranuar vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim, ku e njëjta e ka refuzuar kërkesën tonë me arsyetimin si në vijim:

Sa i përket vlerësimit te ofertave, komisioni vlerësues me datën 04.04.2022 ka kërkuar sqarime shtesë proj operatorit ekonomik "FATI NET" ShPK ne lidhje me markën e produkteve (kamerave) qe ofertoj për te ditur se a integrohet ato lloj kamerave me sistemin e kamerave që janë nëpër Qendrat Korrektues edhe të Paraburgimit.

Me datën 05.04.2022 OE ofron përgjigjeje ku ndër te tjera thotë se marka e kamerave me te cilat unë ofertoj janë DAHUA.

Me datën 08.04.2022 kemi kerhuar nga Zyra e IT-së ne kuadër te SHKK-së qe te dërgon emali te AGJENCIA E SHOQËRIS SË INFORMACIONIT ASHI. Zyra e Zyra e IT-së ne kuadër te SHKK-së ne te njëjtën dite i dërgon email ASHI-së me këtë tekst:
"Përshëndetje,

Ju lutem a keni njohuri për kompanitë e furnizimit me kamera vrojtuese te markës Dahua dhe Hikvision a janë ne ndonjë ndalese administrative apo me ndonjë ndalese te plote.
Ju lutem nëse keni mundësi për një njoftim te shpejt sepse po me kërkojnë nga prokurimi i SHKK-së".

Përgjigjeje e ASHI-së është:
"E nderuar,

Të dy këto lloje të kamerave janë në listën e zeze të SHBA-ve dhe gjithashtu janë vendore te pasigurte, por nuk e di që ka një ndalese të tillë në Kosovë, megjithatë në nuk do ju lejojmë që të njëjtat ti futeni në rrjetin qeveritar, ...".
Ekzistojnë dy vendime për sanksionimin e prodhuesve te këtyre kamerave nga Qeveria e Republikës se Kosovës njeri nr. 07/66 i datës 23.02.2021 dhe tjetri nr. 05/03 i datës 02042021.

AK-ja në vendimin për refuzim i ka bashkangjitur dy vendimet e lartcekura të Qeverisë së Kosovës, një të nxjerr nga Kryeministri Albin Kurti i dt.02.04.2022 për zbatim të sanksioneve ndaj 4 personave dhe ndaj një entiteti Kinez duke u bazuar në një vendim të Këshillit të Bashkimit evropian (CFSP) 2021/481.

Sa i përket vendimeve të cilat i është referuar AK-ja në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, ju sqarojmë se Vendimi i nxjerr me dt.02.04.2022 është një vendim i nxjerr pas datës së ofertimit në këtë aktivitet të prokurimit dhe normalisht që nuk mund të zbatohet në këtë aktivitet të prokurimit sepse vendimi i Kryeministrit nuk duhet të ketë pasoja dhe efekt në këtë aktivitet të prokurimit, prandaj ne nuk mund të eliminohemi për këtë arsye.

Për tu eliminuar ne me këtë arsyetim, është dashur që një kërkesë e tillë apo një vendim i tillë të bëhet pjesë e FDT-së dhe e njoftimit për kontratë, pra të jetë kërkesë decidive e dosjes së tenderit dhe atëherë do të ishin të informuar edhe operatorët ekonomik.

Ne nëse do të kishim informacion të tillë atëherë ne nuk do të kishim ofertuar me produkte tjera, duke e pasur parasysh vendimin e lartcekur, andaj në këtë rast nuk mund dhe nuk duhet të merret parasysh vendimi i lartcekur për faktin se i njëjti është marr pas datës së hapjes së ofertave. Nëse ky vendim eventualisht merret parasysh atëherë duhet të trajtohen të gjithë OE në mënyrë të barabartë dhe duhet të anulohet ky aktivitet i prokurimit në tërësi dhe të ritenderohet, ndërsa pas ri tenderimit duhet të përcaktohet kërkesa konform këtij vendimi, pasi që nëse vazhdohet dhe merret parasysh ky vendim atëherëne po diskriminohemi si OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet pasi që kemi ofertuar konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe favorizohet OE i rekomanduar për kontratë.

Po ashtu vlen të ceket fakti se një institucion siç është Ministria e Kulturës, Rinisë dhe

Sportit (MKRS) ka nënshkruar kontratë me një OE me dt.20.04.2022, i cili OE ka ofertuar me kamera të markës **HIK VISION** për aktivitetin e prokurimit ***"Furnizimi dhe instalimi i sistemit të vëzhgimit (kamerave) në objektin e MKRS-së dhe funksionalizimi i laurave për parking".*** Andaj përderisa kjo kontratë është nënshkruar pasi që është publikuar vendimi i lartcekur duhet që të detyrohet AK-ja të vazhdoj me kthimin e lëndës në rivlerësim, në të kundërtën siç edhe e cekëm ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet në tërësi dhe pas anulimit të ndryshohet kërkesa konform vendimit të lartcekur, sepse nëse vazhdohet ky aktivitet i prokurimit sipas vendimit të lartcekur atëherë favorizohet haptas OE i rekomanduar për kontratë dhe po diskriminohemi Ne si OE i përgjegjshëm dhe më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke pasur parasysh faktet që u cekën më lartë, kuptohet që ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe se jemi eliminuar padrejtësisht dhe në kundërshtim edhe me nenin 56.3 të LPP-së duke u diskriminuar ne si kompani e përgjegjshme.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që ***"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*** Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që **Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse"**, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, sepse janë të obliguar që të sigurohen që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të shqyrtoj Ankesën tonë dhe të nxjerr:

4. RAPORTI I KOMISIONIT RI-VLERËSUES

N/A

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË ANKESËS

Përgjigje në pretendimet ankimore te OE ankues

Sqarim hyrës: Fillimisht sqarojmë se pretendimi ankimor i parashtruar në këtë ankesë ka të bëjë tenderin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë. OE ankues ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim dhe ankesë në OSHP mbi pretendimet. Pas shqyrtimit në detaje të pretendimit të OE ankues, analizimit të DT, FPO, specifikacionit teknik, përshkrimi i çmimeve vendimeve të AK, kërkesave për sqarime dhe fakteve të kësaj ekspertize.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1, 2, 3: Nenin 1, Neni 6, Neni 56.3
Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të **OE "FATI NET" SH.P.K. – Komoran, Drenas** lidhur me anulimin e ofertës së tyre nga AK.. për cimimin e ofertës sqaron se AK ka vepruar në kundërshtim me RROUP dhe LPP. Andaj pretendimi ankimor i OE se ka dorëzuar ofetën me cmimin më të ulët ndërsa AK në ka rekomanduar për kontratë OE i cili është me çmimin më të lartë. Si dhe që OE nuk do të diskualifikohen ose përjashtohen nga procedura në bazë të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. Ky pretendim **është i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin ankimor 4, 5, 6: Nenin 59, Neni 60, Neni 69
Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të **OE "FATI NET" SH.P.K. – Komoran, Drenas** lidhur me anulimin e ofertës së tyre nga AK.. sa i përket vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të ofertave AK ka kryer vlerësim për projektin e lartëcekur, dhe se për të gjitha paqartësit dhe dyshimet lidhur me prodhuesit (Vendor) të pasigur sipas vendimeve të qeverisë së republikës së kosovës. Vendimi Nr. 07/66 i datës 23.02.2021 dhe Vendimi Nr. 05/03 i datës 02.04.2021. **ASHI – Ka paralajmëruar AK se ne nuk do të ju lejojmë që të njejtat ti futeni në rrjetin qeveritar.** Ky pretendim **është i pa bazuar**

Sa i përket vlerësimit te ofertave, komisioni vlerësues me datën 04.04.2022 ka kërkuar sqarime shtesë prej operatorit ekonomik "FATI NET" ShPK ne lidhje me markën e produkteve (kamerave) qe ofertoj për te ditur se a integrohet ato lloj kamerave me sistemin e kamerave që janë nëpër Qendrat Korrektues edhe të Paraburgimit.

Me datën 05.04.2022 OE ofron përgjigjeje ku ndër te tjera thotë se marka e kamerave me te cilat unë ofertoj janë DAHUA.

Me datën 08.04.2022 kemi kerhuar nga Zyra e IT-së ne kuadër te SHKK-së qe te dërgon emali te AGJENCIA E SHOQËRIS SË INFORMACIONIT ASHI, Zyra e Zyra e IT-së ne kuadër te SHKK-së ne te njëjtën dite i dërgon email ASHI-së me këtë tekst:
"Përshëndetje,

Ju lutem a keni njohuri për kompanitë e furnizimit me kamera vrojtuese te markës Dahua dhe Hikvision a janë ne ndonjë ndalese administrative apo me ndonjë ndalese te plote. Ju lutem nëse keni mundësi për një njoftim te shpejt sepse po me kërkojnë nga prokurimi i SHKK-së".

Përgjigjeje e ASHI-së është:
"E nderuar,

Të dy këto lloje të kamerave janë në listën e zezë të SHBA-ve dhe gjithashtu janë vendore te pasigurta, por nuk e di që ka një ndalese të tillë në Kosovë, megjithatë ne nuk do ju lejojmë që të njëjtat ti futeni në rrjetin qeveritar, ...".
Ekzistojnë dy vendime për sanksionimin e prodhuesve te këtyre kamerave nga Qeveria e Republikës se Kosovës njeri nr. 07/66 i datës 23.02.2021 dhe tjetri nr. 05/03 i datës 02042021.

REKOMANDIM:
Eksperti shqyrtues teknik lidhur me ankesën rekomandon AK-OE dhe OSHP që të zbatohet Neni 62 për përfunimin e aktivitetit të prokurimit , Neni 62 pika 1.

Neni 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:
<u>një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.</u>

AK – në procedurën riteneruese ti precizoj të gjitha kriteret duke përfshi edhe qështjen e sigurisë dhe vendimeve të cilat mund të jene nga Institucionet vendore të sigurisë dhe Zyres se Kryeministrit (ASHI, Policia Kosovës, etj), në Njoftimin per kontrate, Dosjen e tenderit

Eksperti shqyrtues teknik sqaron që AK dhe komisoni i vlerësimit gjatë procedurës së ritenderimit duhet të kryejn vlerësim profesional duke respektuar nenët 1, 6, 56.3, 59, të LPP-së.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet dhe të gjeturat në ketë ekspertizë, eksperti shqyrtues teknik i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet **si pjesërisht e bazuar** dhe të anulohet ky aktivitet i prokurimit , nëse AK ka interes edhe më tutje në këtë aktivitet të prokurimit atëherë duhet ta Ritenderoj de ti vendos të gjitha kriteret në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues: **AK – Shërbimi Korrektues i Kosovës**
- Panelit Shqyrtues OSHP
- OE ankues **OE "FATI NET" SH.P.K. – Komoran, Drenas**